REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 389/13 Data: 15.01.2013
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 389/13
Datë 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

Për akreditimin e QAKP "Gjon Nikollë Kazazi, Gjakovë, për periudhën: 15/12/2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit (niveli i KKK-së IV)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Meqenëse objekti është nën vëzhgimin e kamerave, rekomandohet që të vendosen shenjat informuese që jeni nën vëzhgimin e kamerave. Kjo është obligim ligjor.
- Aparateve kundër shuarjes së zjarrit u ka skaduar afati. Rekomandohet që të behet kontrolli i rregullt,
- Në lëndët e programimit, praktikohet Visual Studio 6 (Visual Basic 6). Rekomandohet që të kalohet në kornizën .NET.
- Kompjuterët që posedon shkolla kanë të instaluar sistemin operativ dhe programe aplikative të pa licencuara. Rekomandohet që mos të instalohen programe të pirate,

por të bëhet përpjekje që të merren edicione akademike e që në shumicën e rasteve janë falas.

- Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit si dhe aplikacioneve të validimit dhe akreditimit nuk është sipas udhëzimeve të Autoritetit të Kualifikimeve Kombëtare. Raportet kryesisht përmbajnë informacione për profile tjera si për Administrim biznesi. Rekomandohet që herëve tjera ti kushtohet kujdes më i madh plotësimit të raportit të vetë-vlerësimit si dhe aplikacioneve të validimit dhe akreditimit. Po ashtu në këtë proces duhet të përfshihen i gjithë stafi.
- Gjuha e përdorur në plotësimin e raporteve dhe aplikacioneve është larg standardit. Rekomandohet që ti kushtohet kujdes gjuhës standarde.
- Krijimi i literaturës së përshtatshme dhe sipas standardeve gjuhësore.

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.09.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

   - QAKP "Gjon Nikollë Kazazi, Gjakovë;
   - AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi